



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 01/40**  
**Datë: 15.10.2021**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, nenit 93 paragrafi 4 dhe nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, nenit 5 paragrafit 2.4, nenit 6 paragrafit 1, nenit 10 dhe nenit 12 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi ,duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe duke marrë parasysh kërkesën e kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 14 tetor 2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 tetor 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit Nr. 01/37 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.09.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19**


1. Në pikën 15 të Vendimit Nr. 01/37 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 24.09.2021, shtohet një nënpikë si në vijim:

“15.6. personave të angazhuar zyrtarisht për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, duke përfshirë anëtarët e këshillave të vendvotimit dhe vëzhguesit e procesit zgjedhor, me qëllim të kryerjes së detyrës zyrtare, nga ora 22:00 e datës 16 tetor 2021, deri në orën 05:00 të datës 18 tetor 2021”.

2. Obligohet Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse të mbikëqyrin zbatimin e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr.07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- KQZ-së;
- Komunave;
- Inspektorateve përgjegjëse;
- Policisë së Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.